



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

Nr. 882/1 prot.

Vlorë, më 09 .07 .2018

VENDIM

Nr. 33, datë 09.07.2018

**PËR
MIRATIMIN E PROGRAMIT TË RI STUDIMI DYVJEÇAR
"TEKNIK LABORATORI"**

Mbështetur në nenin 72, pikën 7 të nenit 25, shkronjën **dh**, pika 1 në nenin 38 në ligjin Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", VKM nr. 31, datë 29.12. 2017 "Për përcaktimin e kriterëve, dokumentacionit dhe procedurave për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e programeve të studimit nga institucionet e arsimit të lartë", VKM nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", Senati Akademik në mbledhjen e datës 09.07.2018

VENDOSI:

1. Të miratojë, pas plotësimeve të rekomanduara, propozimin e Departamentit të Kimisë për program të ri studimi dyvjeçar "Teknik laborator".
2. Vendimi i përcillet për miratim të mëtejshëm Bordit të Administrimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Roland ZISI

